

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 10 SHKURT 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë që na ndiqni,

Tashmë të gjithë qytetarët e këtij vendi e dinë se shtegu i anëtarësimit në familjen europiane kalon nën harkun e restauruar të drejtësisë. Them të restauruar, sepse 200 magjistratët, të cilët kanë kaluar provën e vështirë të besueshmërisë profesionale, të integritetit pasuror dhe etik, janë tashmë garancia e rikthimit të besimit të publikut te drejtësia. Janë këta gjyqtarë dhe prokurorë, që tashmë u kanë kthyer besimin edhe qytetarëve që po sot protestonin, se do të gjykojnë me drejtësi dhe me paanshmëri nëse shpronësimi, që u është ofruar këtyre protestuesve, është i ligjshëm, është i drejtë. Janë këta gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët tashmë u kanë kthyer besimin edhe familjeve, si familja e trevjeçarit në Fier, të cilët janë duke pritur që drejtësia të vihet në vend, ndërsa ai fëmijë humbi jetën në një kopsht. E pra, sistemi i vetingut, procesi i vetingut, procesi i vlerësimit kalimtar të magjistratëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve ka kthyer tashmë besimin dhe ka siguruar edhe partnerët tanë strategjikë, të cilët rendin së bashku me ne, hap pas hapi, në maratonën sfilitëse të restaurimit dhe të reformimit të sistemit të drejtësisë. Janë vetëm një pakicë, të gjithë ata që kanë vrapuar në maratona e dinë shumë mirë se maratonën e fillojnë të gjithë, por jo të gjithë e mbarojnë, një grup i vogël heq dorë, kapitullon, thërret “anulim loje”, pra janë vetëm këta, që sot kanë frikë nga vazhdimësia e procesit të vetingut. Janë kapitullonjësit, të cilët i kanë bërë karshillëk sistemit të drejtësisë dhe kanë refuzuar prokurorinë dhe gjykatën të paraqiten si dëshmitarë dhe jo më si të pandehur. Sot nuk kemi asgjë ndryshe nga ai proces vetingu që nisëm së bashku. Sot kemi të gjitha mjetet juridike që nevojiten, që sistemi/procesi i vetingut të vazhdojë dhe të përfundojë me sukses.

Sot kemi sigurinë juridike për të 300 magjistratët, që ende janë duke pritur rivlerësimin kalimtar, sigurinë juridike që ata do të vlerësohen me të njëjtat procedura dhe standarde që janë vlerësuar 500 magjistratët e mëparshëm. Sot kemi barazi para ligjit, kemi barazi për 300 magjistratët, të cilët presin të shkojnë para procesit të vlerësimit kalimtar dhe këtë siguron shtyrja e afatit, ku trupa vlerësuese vazhdon të jetë ajo dhe rregullat e lojës vazhdojnë të jenë po ato.

Sot kemi një Operacion Ndërkombëtar Monitorimi, i cili, me të njëjtën vëmendje, me të njëjtin skrupolozitet, vazhdon të sigurojë paanshmërinë dhe integritetin e procesit. Sot kemi një kalendar, që kontrollohet rreptësisht deri në fund të vitit 2024. Sot është e dukshme që kemi vullnet të përbashkët që të gjithë së bashku të vazhdojmë maratonën për reformimin e sistemit të drejtësisë. Shpesh ia vlen ta dëgjosh kundërshtarin. E them shpesh, sepse jo gjithmonë është e shëndetshme. Ia vlen të shikosh se nga cili këndvështrim e sheh problemin kundërshtari, ia vlen të dëgjosh arsyet përse e kundërshton një proces të caktuar, por nuk ia vlen kur kundërshtari është duke i vënë stërkëmbësin procesit më të rëndësishëm, i cili vë gurin e themelit në demokracinë shqiptare. Siç porosiste Noli i madh maratonmakun, që i thoshte: “Kujdes, se ato që të dalin rrugës dhe të duken si baballarët apo si nënat e drejtësisë, janë vetëm shtriganët dhe magjistricat që do të të pengojnë rrugën”. Ndaj, është

jashtëzakonisht e rëndësishme që ne sot, të gjithë së bashku, të mbyllim veshët për të gjithë stërkëmbëshat e këtij procesi shumë të rëndësishëm, të votojmë vazhdimësinë e vetingut, i cili do të sjellë realitetin e munguar dhe të mohuar për qytetarët e këtij vendi, se të gjithë jemi nën sundimin e ligjit dhe të barabartë para tij. Faleminderit!